

## Kreu 2

### Krijimi i radios së fuqishme. Gojëshkathëti.

*“Njeriu pikturon me mendje, jo me duar”*  
Mikelanxhelo (1475-1564)

Ndërsa radio muzikore zhvillohet drejt një paraqitjeje të teknologjisë së lartë e me strukturë të ngurtë (nganjëherë jonjerëzore), faktori personalitet prirret të kufizohet vetëm në transmetimin e mëngjesit ose madje edhe të pengohet. Por emisionet e mëngjesit kanë prirje të mbushen me kaq shumë elementë të tjerë – lajmet, spotet e shumta, trafiku, koha, linjat e transportit dhe reklama që vihen njëra mbi tjetrën për pjesë të tjera të ditës – sa që shpesh, edhe atëhere, pak kohë mbetet për shfaqjen e personalitetit.

Përherë e më tepër, dixhejtë e FM-së e shikojnë emisionin bisedor si një vend ku mund të jenë të lirë të shprehin vetveten për më tepër se 45 sek. njëherazi.

Personalitetet krijuese të radios e quajnë zhgënjyese të mos bëjnë tjetër veçse të lexojnë skeda linjash. Haward Stern, Gary Burbank, Rush Limbaugh, Phill Hendrie dhe Steve Dahl, midis të tjerëve, ishin të gjithë dixhej që transmetonin muzikë para se të bëheshin folës në radio.

Këta të gjithë janë individë shumë të ndryshëm, por elementi i përbashkët i tyre është se ata kanë mendime të fuqishme, janë zbatimës dhe kanë gjithmonë gjëra për të thënë. Ata janë aktualë, janë të interesuar për opinionet e dëgjuesve dhe kanë kënaqësi të bisedojnë me njerëzit. Ata gjithashtu janë pak më të rinj se sa folësit prezantues tradicionalë dhe mund të sjellin në radio njerëz të moshave më të reja.

Shumë njerëz krijues ishin joshur për të punuar në radio sepse ishin të prekur në mënyrë të jashtëzakonshme nga muzika. Ajo shprehte diçka. Disa thonë se rreth 20 vjet më parë muzika ishte më shprehëse dhe reflektonte kohën. Një pjesë e muzikës në radio ishte e gjallë dhe jetësore.

Kjo është ajo që shprehin më të shumtat e emisioneve bisedore. Radioja e sotme. Marrëdhëniet e sotme. Afërsisht ndarja e jetës tuaj me njerëz të tjerë për të mos u ndjerë i vetëm.

Vite më parë më rastisi të transmetoj gjatë natës në stacionin bisedor KOA të Denverit. Duke marrë ato thirrje të vona prej njerëzve nga e gjithë Amerika, nga rreth 38 shtete (KOA me 50.000 vatët e tij është një kanal që dëgjohet pastër) unë mësova se njerëzit *kanë nevojë* të dëgjohen. Se duke telefonuar gjatë gjithë natës lehtësohej vetmia kolektive e dëgjuesve të ngjitur pas radios. Sa e fuqishme mund të jetë radioja! Në librin e tij “Valët e Radios” Xhim Ladd e quan atë, “të rrish ulur rreth ngrohtësisë së zjarrit të radios, si rreth një zjarri kampingu, të etur për tingullin e daulles fisnore.”

Ngjalli një farë reagimi kur Bruce Springsteen këndoi rreth fabrikave që po mbylleshin, për mungesën e shpresës midis të rinjve, për rebelimin e rinisë, për hipokrizinë në kulturë – “rrembe të dashurën, hip në një motoçikletë dhe dil jashtë qytetit,” apo bëj dashuri tani, sepse mund të mos ketë një të nesërme.

Disa e quajnë këtë art muzikor. Të tjerët e quajnë poezi dhe muzikë të zhvendosur në publicistikë. Po të njejtët dëgjues sot mund të dëshirojnë të dëgjojnë të njëjtat tema të diskutuara në formatin e emisionit bisedor—e papërfytyrueshme kjo në strukturën e

1970-s të radios bisedore më tradicionale. Shumë Di Xhej të mëparshëm del të jenë pikerisht njerëzit e duhur për të drejtuar radion bisedore “të re” e cila është më e zjarrtë, më moderne, më krijuese, e orientuar drejt personalitetit, radio bisedore e ndikuar nga muzika.

Natyrisht, nëse ju dinit ku të kërkonit nga fundi i viteve 60 dhe fillimi i viteve 70 mund të dëgjoni disa materiale shumë provokative në stacionet FM si WBAI | Nju Jork, KMET | Los Angeles, KSAN | San Francisko, KPFB | Los Angeles dhe KPFA | Berkli.

Këngë rreth mbarimit të luftës në Vietnam, drogës, rebelimit, politikës dhe një koncepti të paqartë të “lirisë.” Përsëri një “publicistikë rinore” e kohës, e zhvendosur në këngë. Nëse do të drejtonit njerin nga këto emisione muzike, ju mund të bisedoni, të ishit një përkrahës, të merrnit telefonata, të thonit atë që mendoni, të futeshit në kategorinë e “përgatitësve të lajmeve” dhe të ishit në qendër të veprimtarisë gazetareske.

Gjërat tani janë ndryshe, por gjithashtu disi edhe njëllëj. Stili i folësit tradicional të radios bisedore të viteve 60, një moderator shpesh pa ngjyrë e pa opinione, thajse ka kaluar tashmë në histori dhe është zëvendësuar me një tjetër, të llojit të personalitetit të fortë; në këto FM plot ngjyra – tip stacionesh muzike “hipi”, tani dëgjohen folës-përkrahës.

Mbajtja e një auditori kërkon të transmetohen tregime të shumta. Shijet e vjetra u gjenden para sfidave. Ato përzien përvojat individuale të shkrimtarit | interpretues me rrëfimin e shkëlqyer të tregimeve. Dhe ky është thelbi i radios së famshme bisedore.

Me sa duket më i famshmi deri tani, i këtyre djemve “gojëshkathët” është folësi i emisioneve bisedore, Rush Limbaugh. Emisioni i tij mbështet një program gati në të njëjtën mënyrë që radio FM e 60-tës ngrinte në politikë kulturën pop dhe çështje të ditës. Krahas vlerave të prodhimit radiofonik ai i shton emisionit elementin e argëtimit dhe ngacmimit emocional, grimca të krijuara, tringëllima dhe parodi, të gjitha të mbështjella me një dozë të bollshme politike konservatore – një hapësirë e pastër nga humori në të shkuarën. Rush mori diçka që kishte qenë tradicionalisht e ngurtë dhe e bëri atë burim argëtimi.

## **Rush Limbaugh**

### **Fotografi. Faqe 11.**

Unë punova me Rushin në WABC | Nju Jork më 1990. Krahas emisionit të vetë dy orësh të asaj kohe për rrjetin EFM, ai bëri një emision lokal dy orësh enkas për ne.

Njerëzit më pyesin vazhdimisht “Çfarë tipi është ky Rush?” Ajo që më kujtohet më mirë nga puna me të është profesionalizmi i tij. Unë nuk kisha pse të shqetësohesha kurrë për të. Ai nuk ishte person problematik. Ai ishte i këndshëm dhe i edukuar—i sjellshëm në mënyrën e Mesperëndimit —dhe punonte shumë. Ai shkonte në zyrë herët—orë të tëra para emisionit, duke kontrolluar duzina gazetash, duke kërkuar për material dhe duke u përgatitur për emisionin. Nuk kishte nevojë për shumë gjëra. Një zyrë të vetën. Një telefon të vetin. Ndonjë cigare here pas here. Ai ishte një djalë zbavitës dhe kishte lezet të pije një kafe me të.

Limbaugh e shpjegon suksesin e tij në librin “Mënyra si duhet të jenë gjërat”. Ai thotë se shansi i madh iu kthye më 1984 në radion KFBK në Sacramento të Kalifornisë,. Ai e ndjeu se emisioni funksionoi sepse, “Mu lejua të isha vetvetja.” Thotë se ishte hera e parë gjatë 17 vjetëve në radio që iu lejua të ishte origjinal gjatë transmetimit. Limbaugh

paralajmeron, “Ju nuk do të jeni kurrë më i mirë duke vepruar sipas mënyrës së dikujt tjetër.”

Limbaugh mëton se emisioni i tij është kaq i suksesshëm sepse ai e zbavit auditorin dhe jo sepse rrjeshtimi i tij i djathtë politik është më i drejtë. Ndonëse Rush e pranon që njerëzit e pëlqejnë këndvështrimin e tij politik, sidoqoftë janë instinktet e tij për radion që japin rezultat. Ai paraqiti një pamje “[moderne]” për konservatorët, i pasqyroi ata dhe e bëri radion zbavitëse dhe personale. Dhe kjo funksionoi. Emisionet e tij ngjallën interes në mbarë Amerikën, nga dëgjuesit erdhën miliona letra. Tashmë janë mbi 650 stacionet që ritransmetojnë emisionin e Rush dhe ai është njohur si “shpëtuesi” i radios AM.

I vetmi djalë tjetër konservativ i radios me të njëjtët lloj ndjekësish është gazetari dhe komentatori Pol Harvey. Dhe thujse për të njëjtat arsye. Secili ka krijimtarinë e tij unike, të shprehur në stilin e tij vetiak. Harvey është një rrëfimtari mjeshër dhe që ke qejf ta dëgjosh. Ju mund të shikoni gjatë kohës së drekës në vendparkime njerëz të ulur nëpër makinat e tyre duke dëgjuar deri në fund, si të hipnotizuar, Pol Harveyn.

Morali për sukses: Jini unik. Jini vetvetja. Krijoni stilin tuaj vetiak.

### **Trajtoni thirrjet sikundër sukseset. (hitet).**

Tjetër sekret i suksesit të Limbaugh është se ai i “trajton” telefonuesit sikundër një dixhej trajton këngët. Ai e kuptoi që radioja bisedore nuk është radio e shërbimit publik dhe kur dikush i telefonon emisionit nuk do të thotë se ai ka të drejtën e dhënë nga Zoti për tu dëgjuar në transmetim. Ai thotë:

*“Për mua qëllimi parësor i telefonimeve në emisionin tim është që unë vetë të ndihem mirë dhe njëherësh të mos lejoj që mikrofoni të kthehet në një tribunë për të mbajtur fjalime. Jam unë, në fund të fundit, që duan të dëgjojnë njerëzit ... dy minuta për një telefonues të mërzitshëm është njëlloj si të vesh një disk që nuk e pëlqen askush. Çfarë bëni ju kur interpretohet një këngë që nuk ju pëlqen? Kërkoni të gjeni një tjetër që u pëlqen.”*

Pavarësisht nga pesha që i jepet këtij stili të ri “më të zjarrtë” të radios bisedore, duke iu drejtuar të rinjve -dhe programatorët kapen në mënyrë të dëshpëruar pas këtyre dëgjuesve më të rinj dhe shumë të respektuar—mos e lejoni atë të prekë gjykimin tuaj për talentin. Ia vlen të kujtojmë: qofshin personat 18 apo 80 vjeç, nëse ata magjepsin me mendimin origjinal dhe aftësinë tregimtare, arrijnë të rrëfejnë qëndrimin e tyre ndaj së vërtetës dhe përçojnë interesin e tyre për jetën, ju do të keni sukses!

### **Çfarë tjetër sjell një gojëshkathët në tavolinën e bisedës?**

Talenti mund tju çojë larg, por ai duhet përforcuar me përvojë.

### **Ritmi**

Një përparësi e vërtetë që i dallon biseduesit e shkathët është ndjenja e ritmit. Ju mund ta ndjeni shkëlqimin dhe përvojën e një djali si Limbaugh apo Howard Stern. Ata kanë për ritmin një instinkt të edukuar në vite nga thyerjet segmentshkurtra gjatë transmetimit. Ata dinë si ta trajtojnë problemin, të arrijnë shpejt tek ai dhe të dalin prej tij.

## **Më pak do të thotë më shumë.**

Dixhejtë e mëparshëm kanë mësuar ku duhet ta përfundojnë një moment, për të kaluar pastaj tek diçka tjetër. Duke dëgjuar regjistrimet ju mund të ndjeni ndryshimin midis një talenti me përvojë që është ndeshur me kohën dhe ka fituar dhe një fillestari të talentuar që ende nuk e ka kapur plotësisht ritmin. Kjo përgatitje, e cila arrihet vetëm nëpërmjet përvojës, është e paçmueshme dhe pasqyrohet në radion bisedore, madje edhe pa kufizimet e ngurta të regjistrimeve dhe një ore format. Mësimi këtu është: me të gjetur nja dy orë për të luajtur mos i humb ato!

## **Si ta “gjallëroni” bisedën.**

Një tjetër dixhej që bëri këtë kapërcim është Fill Hendri i WIOD | Majemi. Pas një karriere të sukseshme 20 vjeçare në radion muzikore, përfshi këtu një listë stacionesh të majës së FM-ve amerikane dhe të rrjetit të projekteve Westwood One, ai, ndërsa bënte transmetimin e mëngjesit në strukturat e ngurta të KLSX-FM|Los Angeles, filloi të ndihej si i mbërthyer nga mungesa e lirisë. Kur stacioni i tij vendosi të kryejë një ndryshim, ishte viti 1988, dhe KFI|Los Angeles, e zotëruar nga Cox sapo i kishte dhënë formë bisedës së “nxehtë” KFI i dha atij një emision fundjave në Los Angeles.

## **Phil Hendrie**

### **Fotografi. Faqe 14.**

Hendri ishte një djalë krijues dhe me mundësi të jashtëzakonshme. Pas një farë kohe ai shkoi në KVEN|Ventura, Kaliforni, për një emision mbasditeje në mesjavë, ku e përpunoi lojën e tij dhe u bë i famshëm. Vazhdoi më tej në WSB|Atlanta, WCCO|Mineapolis dhe përfundimisht arriti majën e folësve të lajmeve në Majemi. Ai është krijues, zbatimës, ka një karakter të përcaktuar, bën një milion zëra individualë, ka pikëpamje dhe gjëra interesante për të thënë, pëlqen sportin, pëlqen me të vërtetë gratë si qenie njerëzore dhe zbulon kush është dhe çfarë mendon ai për auditorin.

Hendri vëzhgon jetën, e filtron gjithçka që shikon përmes procesit të tij krijues dhe e lë atë të rrjedhë. Tani ai punon në një stacion ku e vlerësojnë dhe e besojnë dhe është shndërruar në një talent mahnitës.

## **Fill Hendri për Krijimin e Radios së Fuqishme:**

° *Hyni brenda dhe lëshohuni.* Provoni gjithçka. Radioja e fuqishme është eksperimentim. Nëse stacioni ku jeni tani nuk e vlerëson këtë, herët a vonë ju do të gjeni një të tillë.

° *Jini një shpërndarës i kulturës popullore dhe jo vetëm i TV dhe filmave.* Kjo do të thotë vini re rrobat, shenjat e rrugëve, shitjet e makinave, fytyrat, thekset, ngjyrat e dritareve, bimët shtëpiake, copëzat e bisedave, dokrrat, etj. Regjistroni gjithçka.

° *Harrojini telefonuesit.* Përgatitni emisionin në mënyrë që materiali të jetë interesant së pari për ju, së dyti për dëgjuesit dhe së treti për telefonuesit

° *Jini krejtësisht të qartë dhe të përqëndruar përsa i përket emisionit.* Drejtuesi ka prirje të sorollatet dhe të të mbushë me këshilla, ndonëse talenti i mungon. Ju do të gjeni dhe do të merrni shumë këshilla të këqia.

° *Ruajeni emisionin tuaj nga tepërimet.* Ka të bejë me ju. Nëse nuk ua keni nevojën lerini ndihmësat, bisedën e lumtur me gazetarin e lajmeve, telefonuesit kronikë.

° *Mos pararegjistroni grimca.* Bëjeni punën në mënyrë të drejtëpërdrejtë. Çdo të ndodhë nëse drejtoni keq një efekt tingulli apo një linjë. Shanset tuaja për të patur sukses me një grimcë arrijnë deri 100 % kur e bëni atë në mënyrë të drejtëpërdrejtë. Mos shkruani më tepër se sa duhet. Kini parasysh aftësinë e të improvizuarit në çast.

° *Flakeni tej postën e dëgjuesit.* Nëse ata kanë diçka për të thënë, do të telefonojnë. Dëgjuesit që i shkruajnë prezentatorit të [emisionit] shfaqjes bisedore janë eksentrikë.

° *Vëri veshin e shumta një kontrolli në muaj.* Duke dëgjuar më shumë kontrolle vetëm do të brengoseni, do të jetë sikur të kërkonin qimen në vezë. Nëse bëni një përshtypje të dobishme në transmetim, ju do ta ndieni atë.

### **Si e ndërpres unë bisedën?**

Unë marr çdo ditë telefonata nga folësa që punojnë në emisionet muzikore ose redaksi lajmesh dhe që nëpërmjet telefonit të hapur duan t'i japin një provë radios bisedore. Problemi i tyre është *të lidhen drejtëpërdrejtë* diku për të provuar që mund ta bëjnë këtë. Ata zakonisht nuk kanë ndonjë përvojë në bisedë, aq më tepër në një regjistrim të kontrolluar. Edhe programi i së dielës i intervistave rreth punëve të bashkësisë nuk i pengon ata.

Pa kaluar nëpër një test vështirë të gjesh ndonjë drejtor programi që të rrezikojë tju fusë në transmetim. Dhe kur drejtorët e programit dëgjojnë shiritin e muzikës, ata përpiqen të mos i kushtojnë vëmendje. Zërat e mira në radion bisedore janë dytësore. Është ajo çfarë thoni ju që, kryesisht, ka rëndësi këtu.

Më tej, si do të dilni me ndonjë lloj regjistrimi për të nxjerrë në pah personalitetin dhe potencialin tuaj si folës? Apo, si mund të bindni një programator t'ju fusë në një "dëgjim prove" si zëvendësues i folësit? Dhe a jeni i sigurt se e dëshironi këtë dëgjim prove?

### **Dixhej: a jeni gati t'ia nisni bisedës?**

° A i dëgjoni emisionet e bisedave dhe a i pëlqeni ato më shumë se emisionet muzikore?

° A nervozoheni kur materialet janë copëza nga gazetatat, ose kur nuk mund të gjeni ndonjë gjë më me peshë sesa stacioni USA Today\* apo Plejboj?

° A jeni abonuar në 10 apo në më shumë revista apo gazeta?

- ° A telefononi gjatë emisioneve bisedore?
- ° A e kini zët drejtorin tuaj të programit kur ju thotë “mbylle gojën, realizo linjat mos iu ndaj rendit të këngëve në regjistër?”
- ° A i kini zët “hitet?” (këngët më të bukura të vitit)
- ° A e kontrolloni shpesh orën dhe a ndiheni, përgjithësisht, i mërzhitur gjatë transmetimit?
- ° A kënaqeni duke marrë telefonata gjatë transmetimit, apo bëni më tepër telefonata nga sa kishit menduar?
- ° A ju pëlqen të bëni intervista dhe a do të dëshironit të bënit edhe më tepër?
- ° A do të dëshironit të kishit më tepër kohë transmetimi për të biseduar rreth gjërave që kanë rëndësi – çfarë të rejash ka, ç’po ndodh në qytet, etj?

### **Jo të gjitha mizat bëjnë mjaltë.**

Edhe në rast se e gjeni rastin për ta bërë këtë provë dëgjimi në transmetim, kjo mund të mos jetë mënyra më e mirë “për të shpalosur aftësinë tuaj.” Një provë dëgjimi nuk është më e mira e mundshme. Duke qenë në “vend të nxehtë” njeriu nervozohet.

E di nga përvoja vetiake se njerëzit që kalojnë provën mirë janë pakashumë si nxënësit që i kalojnë me sukses testet në shkollë. Ata që i marrin testet janë të zotë në teste. Por nuk është e thënë që ata të jenë domosdo më të zgjuarit, më të mirët, apo talentet më të shkëlqyera.

Programatorët mund të zhgënjehen. Ata mund të dëgjojnë një regjistrim të shkëlqyer ose një provë nate, ta pajtojnë personin dhe më vonë të pendohen kur ai nuk u bë kurrë aq i mirë sa në regjistrim, apo në provë.

Ish-dixhej Turi Ryder shprehet në një mënyrë tjetër. “Çdo person në botë është i aftë të bëjë tri emisione të mira bisedore. Çdo individ ka disa gjëra për të cilat interesohet me pasion, se paku për disa orë. Pas kësaj, kjo bëhet shumë më e vështirë. Njerëzit krijues gjejnë vazhdimisht interesa të reja, subjekte të reja – ata kanë nevojë të argëtojnë veten. Ja sepse ata dalin çdo ditë me emisione të ndryshme“.

Regjistrimet e mia të preferuara që duhen dëgjuar nuk janë detyrimisht transmetimet e kontrolluara. Megjithëse regjistrimet e kontrolluara janë të rëndësishme, ato mund të jenë të montuara pak me tepëri për të lënë mbresa të mira. Mua më pëlqen të regjistroj intervista me koferencierë të fuqishëm emisionesh bisedore ose, kur kjo nuk është e mundur, i kërkoj koferencierit të intervistojë vetveten. Kjo mund të bëhet në shtëpi me magnetofon xhepi. Poqese mjaullin një mace në sfond, përgatituni ta zhfrytëzoni atë si pjesë të emisionit tuaj.

Mendoni për këtë regjistrim si për një biografi të folur, ku ju jeni i lirë të tregoni historitë që keni më për zemër rreth vetes dhe jetës suaj. Kjo jo vetëm që nxjerr në pah aftësinë tuaj prej tregimtari—një pjesë shumë e rëndësishme e emisioneve bisedore— por edhe i ndihmon njerëzit tju njohin në mënyrë të shkëlqyer dhe shumë personale. Disa nga regjistrimet më të mira dëshmojnë për përvoja kuptimplota që kanë ndryshuar apo prekur

njerëzit, përvoja që i kanë bërë ata ashtu siç janë sot. Sa më vetiake të jetë një histori, aq më universale është ajo.

Një tjetër ide e programatorëve është t'i japin konferencierit të fuqishëm një emision bisedor hipotetik. Konferencieri pyetet, “për çfarë do të donit të flisnit poqese u jepen disa orë transmetim?” Ai pyetet përse interesohet për aksh subjekt, përse e gjen atë aq interesant? Ju mund të bëni një “shaka” të modës në hapje të emisionit, një paraqitje të subjektit. Regjistrimi mund të përmbajë disa minuta një monolog të hapur apo “shkundje” me opinione dhe ngjarje personale dhe duke treguar se si disa ndodhi aktuale të ditës janë të rëndësishme për ju dhe dëgjuesit tuaj. Sa më vetiake historia, ose çështja, aq më universale është ajo.

Njëherë kisha një kliente, një folëse lajmesh dhe autore që ishte edhe eksperte financiare, e cila kurrë nuk kishte marrë pjesë më parë në një emision bisedor në radio dhe donte ta provonte. Ajo regjistroi historinë magjepsëse të dy zonjave të moshuara, të cilat kishin shkuar te ajo për këshillim financiar dhe aty kishte dalë që ato, si rezultat i hobit të tyre për të grumbulluar pjata antike, ishin milionere. Regjistrimi prej 10 minutash i dha asaj mundësinë të dëgjohej dhe të zëvendësonte folësit e disa stacioneve dhe rrjeteve kryesore të vendit edhe pse pa përvojën e folëses së mirëfilltë të radios.

### **Turi Ruder.**

#### **Fotografi. Faqe 19.**

Kur e takova unë, Turi Ryder ishte folëse në CHR KIIS-FM|Los Angeles. Ajo kishte një biografi në kuptimin e plotë të fjalës. Dyzet ditët e saj në krye të listës së dixhejve përfshijnë disa nga stacionet më të mira në Amerikë. (ÇLS-AM|Chikago dhe KFRC& KIOI| San Francisko). Ajo ishte e mprehtë, zbavitëse, sugjestionuese e adhurueshme, por në mënyrën e vet. Mendova që do të ishte e përsosur për emisionet bisedore. Ajo vazhdoi me emisionet e mëngjesit në KGW|Portland pastaj në KSTP|Mineapolis. Sot ajo është kthyer në shtëpi, në Cikago, si folëse radioje në WLS.

#### **Këtu poshtë janë disa informacione më tepër nga folësja tepër aktive Turi Ryder:**

- ° Cilësia e emisionit lidhet me aftësinë tuaj për të qenë zbavitës dhe jo me atë që ju mendoni se *dëgjuetit* duan.
- ° Mos u frikësoni të thoni në transmetim “Nuk e di” Auditorët parapëlqejnë ndershmërinë dhe padijen, nga dredhitë dhe arroganca.
- ° Pak qetësi mund të jetë një gjë me vlerë.
- ° “Simpatia” është një luks që ju nuk mund ta siguronit gjithmonë.
- ° Vendosni rregulla për emisionin tuaj, pastaj interpretoni sipas tyre.
- ° Ju keni 50.000 wat dhe një mikrofon, telefonuesit kanë vetëm një telefon dhe një radio. Krijoni një mundësi për ata.

- ° Kurrë mos u tallni me një telefonues pasi ai të jetë larguar. Përrjashtim: poqese të ndërpret telefonatën.
- ° Ndryshimi i emrave të dyqaneve dhe njerëzve ju lejon t'í dalloni më shumë të vertetat, ose, në përmasa më të mëdha, më mirë gënjeshttrat.
- ° Jo kushdo që ka bërë diçka interesante është interesant.
- ° **Çdo gjë është informacion!**